



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 3403 Prot.

Tiranë, më 7.10.2022

**Lënda:** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike””.

**Drejtuar:**

Znj. LINDITA NIKOLLA  
KRYETARE KUVEDIT TË SHQIPËRISË

**E nderuar zonja Kryetare,**

Bazuar në nenin 81, pika 1, “Kushtetuta së Republikës së Shqipërisë”, si edhe në nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**Deputeti propozues**

*Deputi Vanili*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2022

**“PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 43/2015 “PËR SEKTORIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 49 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Pika 1 riformulohet si vijon:

1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, të cilat nuk janë objekt koncesioni, ose çdo kapacitet i ri prodhues deri në 2MW, miratohet nga Agjencia përgjegjëse për burimet natyrore. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese mbi 2 MW, të cilat nuk janë objekt koncesioni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë.

Në pikën 4, shtohet fjalia si vijon:

Për vetëprodhuesit, ndërtimi i kapaciteteve të energjisë nga burimet e rinovueshme deri në 2MW që prodhojnë energji elektrike nga dielli, miratohen nga Operatori i Shpërndarjes, nëpërmjet miratimit të pikës së lidhjes dhe miratimit të aksesit për palët e treta.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**LINDITA NIKOLLA**

## RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

### DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE””

Problemi i energjise elektrike eshte nje ceshtje madhore, qe influencon direkt ne ekonomine e vendit dhe ne buxhetet familjare te qytetareve vecanerisht ne keto kohe te veshtira te rritjes shume te madhe te cmimeve te saj

Shqipëria është vend neto importues i energjisë elektrike. Kapaciteti aktual i instaluar për prodhimin e energjisë është 2607MW, dhe nuk është i mjaftueshëm për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji. Periudha e pamjaftueshmërisë është kryesisht nga Qershori deri në Nëntor, në varësi të kushteve hidrike.

Qeveria nuk e ka ende ne operim bursen shqiptare te energjise

Qeveria nuk ka miratuar ende operatorin e energjive te rinovueshme

Qeveria nuk ka miratuar ende modelin e Kontrates per Diference ne zbatimin e Modelit te Tregut Shqiptar te Energjise dhe sipas Udhërrëfyesit për Hapjen e Tregut Nr. 28 dt 18.01.2021

Qeveria nuk ka permbushur detyrat sipas Planit te Konsoliduar te Veprimit per Burimet e Rinovueshme te Energjise ku pergjate viteve 2019-2020 do te instaloheshin centrale me kapacitete te instaluara prej 490 MW nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme fotovoltaike

Qeveria nuk ka permbushur detyrat per ndertimin e kapaciteteve te instaluara te prodhimit te energjise se rikuperuar nga mbetjet prej 41MW

Sipas planit kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë të miratuar me vendim nr. 580 datë 28.08.2019, ishte parashikuar rritja e kapacitetit të instaluar të prodhimit nëpërmjet burimeve të rinovueshme të energjisë, kryesisht hidrike dhe diellore.

Aktualisht kapacitet e instaluara të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike është 23 MW në total.

Për liberalizimin dhe stimulimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese nga burimet e energjisë së rinovueshme nevojitet të rregullohet pika 1 e nenit 49 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Kjo është domosdoshmëri, sepse Shqipëria ka kapacitet të instaluar të pamjaftueshëm për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Keto ndryshime do te jene nje shtyse e re per plotesimin e objektivave kombetare per prodhimin ne energjise se rinovueshme qe per 2020 ishin 38 %.

Liberalizimi i tregut do te mobilizojte nje gatishmeri me te madhe te konsumatoreve familjare e private per te investuar ne keto impjante, duke shmangur pengesat burokratike.

Gjithashtu, nje motivim tjeter i rendesishem do te jete gatishmeria e qeverise per te marre pjese si bashke-investitor me privatin.